



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni Pranveror**  
**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Mbledhja nr.32**  
**Prishtinë, më 22.04.2010, ora 13:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Petar Miletić, Sanije Aliaj, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Mursel Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha, Hetem Arifi, Sadik Idriz, Hafize Hajdini, Müfera Şinik dhe Xhevdet Neziraj.

**Munguan:** Zafir Berisha.

**Pjesëmarrës të tjerë:** monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE-së, KDI – së.

**Nga Stafi Mbështetës:** Natasa Prica, Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli.

**Mbledhjen e kryesoi:** Petar Miletić, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.04.2010;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligji për Pagat e Nëpunësve Civil me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
- 6. Të ndryshme.**

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi** njoftoi se në takimin që është mbajtur në mes kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të komisioneve, është kërkuar nga komisionet të punohet me zhuritë më të madh në procedimin e ligjeve. Edhe pse është vendosur të thirret bordi i RTK-së, kjo mbledhje është thirrur urgjente.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 17.04.2010**

**Sanije Aliaj** thekoi se në mbledhjen e kaluar, në pikën të ndryshme ka shprehur opinionin e saj lidhur me efikasitetin e punës së këtij komisioni në zbatimin e planit të punës, dhe për këtë çështje emri im nuk figuron fare.

**Kryesuesi** konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar, mbajtur më dt. 17.04.2010, miratohet me vërejtjet e znj. Sanije Aliaj.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente**

**Kryesuesi** theksoi se ky projektligj është përkthyer në shpejtësi dhe përmban shumë gabime gjuhësore. Disa nene të pakuptimta, e që duhet përmisuar para miratimit të ligjit në Kuvend. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e ICO, kemi analizuar projektligjin dhe kemi vlerësuar se është në interes të komuniteteve që amendamenti 10 të plotësohet. Më pas lexoi propozimin për ndryshim.

**Enis Kervan** përshëndeti kontributin e ICO në këto propozim amendamente. Megjithatë kemi probleme në punësimin e komuniteteve joshumicë. Kemi raste kur pjesëtarët e komunitetit shumicë, punësohen si komunitet joshumicë. Sa i përket amendamentit të propozuar për plotësimin e nenit 10.3 në nivelin lokal duhet të jetë një definicion tjetër, që punësimi të jetë konform përqindjeve të komuniteteve që jetojnë në ato komuna. Mos të lihet në formë proporcionale.

**Numan Balic** ajo çka tha z. Kervan është e pranueshme. Më së paku në nivelin lokal duhet të jetë i rezervuar numri minimum i të punësuarve. Në këtë drejtim të shfrytëzohen të dhënat nga statistikat e UNMIK-ut apo në bazë të përqindjeve të komuniteteve që jetojnë nëpër komuna

**Kryesuesi** çështja e përqindjes mund të rregullohet me akte nënligjore. Lexoi disa statistika të numrit të të punësuarve të komuniteteve joshumicë që punojnë në disa ndërmarrje publike.

**Sadik Idriz** u pajtua me ato që u than për punësimin në nivelin lokal. Edhe pse regjistrimi i popullsisë është planifikuar vitin a ardhshëm, rezultatet mund të zgjasin. Duhet sanksionuar me ligj që të eliminohen problemet në përfaqësimin e komuniteteve në shërbimin civil, siq ishte rasti në KEK apo Postë.

**Xhevdet Neziraj** përkrahu mendimin e z. Idrizi. Ky komisioni duhet ti kushtoj rëndësi këtij ligji për të rregulluar çështjen e punësimit të komuniteteve joshumicë, sepse me rastin e monitorimit të ligjeve për komunitete kemi vërejtur se në ndërmarrje publike nuk kanë respektuar ligjet janë bërë shkelje në këtë drejtim. Zyrrat lokale për komunitete i kanë shifrat përfaqësues të sakta për komunitetet që jetojnë nëpër komuna. Prandaj mund të shfrytëzohen këto të dhëna dhe të thuhet se

vlejnë deri në regjistrimin e popullsisë. Më pas propozoi që në mbledhjet e radhës, përveç përfaqësuesve të bordit të RTK-së, të ftohen edhe përfaqësues të ndërmarrjeve tjera publike.

**Müfera Şinik** theksoi se është kundër shfrytëzimit të shënimeve të UNMIK-ut. Në Prizren fliten tri gjuhë. Në mungesë të regjistrimit, pjesëtarë të komunitetit shumicë, për qëllime të punësimit, deklarohen si komunitet turk.

**Sanije Aliaj** nga vizita për monitorimin e ligjeve kemi vërejtur probleme në punësimin e komuniteteve joshumicë në ndërmarrjet publike, prandaj ndihet nevoja e rregullimit të kësaj çështje me ligj. Neni 10 ka nevojë për riformulim dhe nuk duhet kufizuar punësimi i komuniteteve në përqindje. Do të duhej të thuhej se punësimi bëhet në bazë të përqindjes së komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

**Mursel Haljilji** mbështeti propozim - amendamentet e bëra në bashkëpunim me ICO. Në nenin 10.3. është thënë qartë dhe nuk ka nevojë të kufizohemi në përqindje, sepse ajo mund të rritet apo zvogëlohet.

**Zylfi Merxha** propozimet nuk përkrijnë me realitetin. Në Prizren ka mbi 5500 romë dhe asnjë nuk është i punësuar në shërbimin civil. Atje është situata e qartë dhe duhet të merren parasysh interesat e këtij komuniteti për punësim.

**Enis Kervan** propozimi i ICO është bazuar në Kushtetutë .Nuk pajtohem me propozimet që të shfrytëzohen informatat nga koha e UNIMIK-ut.

**Drita Morina** (administratore e komisionit funksional) njoftoi se është e autorizuar nga komisioni të njoftoj se për shkaqe teknike një amendament i komisionit funksional nuk është përfshirë në raportin drejtuar këtij komisioni për shqyrtim. Amendamenti përmban një ndryshim teknik, riformulim të një neni.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se me njëmbëdhjetë vota PËR,një KUNDËR (Dragiša Mirić) dhe asnjë ABSTENIM, Komisioni njëzëri nxori këtë:

- I. Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

## **Vërejtje konkrete**

### **Amendamenti 1**

#### Neni 10 Pranimi në Shërbimin Civil

Neni 10 shtohen paragrafët 1,2,3,4 dhe 5 si në vijim:

10.1. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë juridike të kandidatëve.

10.2. Komunitet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

10.3. Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në Komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë.

10.4. Brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria përgjegjëse për administratën publike nxjerr legjislacionin detyësor që rregullon procedurat për të siguruar përfaqësim të drejtë proporcional të komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës në nivel qendror dhe lokal, siç parashihet me nenin 10.3.

10.5. Brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria përgjegjëse për administratën publike nxjerr legjislacionin detyësor mbi procedurat e shërbimit civil: rekrutimi, puna provuese, përkrahimi i punës, vlerësimi i punës, procedurat disiplinore, procedurat e ankimit, orari i punës dhe vijueshmëria në punë, procedurat e pushimit, shënimet e personelit, procedurat për mundësitë e barabarta, si dhe ndërprerja e punësimit.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligji për Pagat e Nëpunësve Civil me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente**

**Kryesuesi** kërkoi nga anëtarët tjerë të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Pagat e Nëpunësve Civil dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, dhe ka konstatuar nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryesuesi** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar

Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, dhe ka konstatuar nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

## **6. Të ndryshme**

**Sanije Aliaj** propozoi që në një mbledhje të Komisionit, të ftohet bordi i PTK-së.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Petar Miletić**